



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Vleresimi i Korporatave  
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa  
Master

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Maj 2018

# Vleresimi i Korporatave

- Viti I-të, Semestri II
  - Departamenti : KF - Master
  - Statusi i lëndes : Obligative
  - Javët mësimore: 15 [ 3 orë ligjerata, 2 orë ushtrime]
  - Mësimdhënes: Prof.Asoc. Dr. Rrustem Asllanaj
  - Asistent: MSc. Valdrin Misiri
  - Orari i ligjeratave: E premte (G1 – ora 15:00 – 17:15 A1)
  - Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 16:30 – 18:00 B1)
- 
- E-mail: [valdrin.misiri@unhz.eu](mailto:valdrin.misiri@unhz.eu)
  - Website: [www.unhz.weebly.com](http://www.unhz.weebly.com)

# Detyra I:

- Kompania “X” pretendon të blejë makineri të reja me kosto fillestare 75.000 euro. Këto makineri janë vlersuar se do të kenë afatin e përdorimit 5 vite dhe vlera reziduale është 5.000 euro. Ato gjatë afatit të përdorimit priten të sjellin kompanisë neto fitim për zhvlersimit sikur në të dhënat në tabelë. Faktori i diskontit është 10%.
- Llogaritni:
  - A. Shkallën e kthimit kontabel (ARR),**
  - B. Metoden e neto vlerës së tanishme (NPV)**
  - C. Shkallën interne të kthimit (IRR) – 15% dhe**
  - D. Periudhën e kthimit (PP)**

# Detyra I:

<b>Aktualisht</b>	<b>Kosto e makinerive</b>	<b>(75.000)</b>
I	Neto fitimi para zhvlersimit	35.000
II	Neto fitimi para zhvlersimit	25.000
III	Neto fitimi para zhvlersimit	10.000
IV	Neto fitimi para zhvlersimit	25.000
V	Neto fitimi para zhvlersimit	5.000
V	Vlera riziduale	5.000

## Detyra 2:

- Firma X është prodhues i lengjeve dhe disa produkteve ushqimore dhe pret të mbajë një dividende konstante prej 5 € për aksion për disa vite. Në qoftese vlera e kthimit të kërkuar/pritur në aksione është 16% atëherë sa duhet të jetë vlera e aksioneve?
- Aksionet preferenciale paguajnë dividende fikse vjetore 4 € për aksion dhe nëse kthimi i prituri është 12%. Sa është vlera e aksioneve preferenciale ?

# Detyra 3:

- Kompania XYZ është një kompani prodhuese dhe prej vitit 2013 deri ne vitin 2017 ka paguar dividend në aksion si në vijim:

Viti	Dividendi për aksion
2017	1.58
2016	1.50
2015	1.35
2014	1.22
2013	1.16

- Kompania ka vlerësuar se dividendi në vitin 2018 është 1.80 euro ndërsa kthimi i kërkuar në aksione është 17%.
- Llogaritni vlerën e aksioneve përmes modelit të rritjes konstante?

## Detyra 4:

- Firma N në fund të vitit 2011 ka paguar dividend 1.20 euro për aksion. Prej 1 janarit 2012 në 5 vitet e ardhshme pret që norma e rritjes së dividendit të jetë konstante prej 13%, pas kësaj rritje dividendi pritet të jetë 8% në vit.
- Sa duhet të jetë vlera e aksionit me 31.12.2011 nëse kthimi i kërkuar është 15%. Llogaritni vlerën e aksionit duke përdorë modelin e rritjes variabile të dividendit?

## Detyra 5:

- Kompania “Steel” ka ne zoterim pasuri ne vlere prej 854.000€, nese te gjitha keto pasuri shiten aktualisht. Vlera e ketyre pasurive ne momentin e shitjes percaktohet ne baze te vleres se tregut.
- Vlera e tregut te gjitha detyrimeve bashke me aksionet preferenciale eshte 440.000 €.
- Llogaritni vleren likuiduese per aksion, nese kompania ka 37.500 aksione ne zoterim.



## Detyra 6:

- Ne fund te vitit 2015 kompania XYZ ne bilancin e saj ka totalin e pasurise prej 41 milion euro. Totali i detyrimeve 29.5 milion euro, duke i perfshire edhe aksionet preferenciale. Ne kete date XYZ ka ne zotrim 168.850 aksione te zakonshme.
- Llogaritni vleren kontabel per aksion.

## Detyra 7:

- Supozojmë se me 31.12.2016 çmimi i tregut për aksion është 6.8 euro. Pra, në fund të vitit 2015 kompania M ka në zotrim 72.000 aksione te rregullta, ndersa fitimi neto i vitit 2015 është 88.640 euro.
- Llogaritni raportin P/E?

## Detyra 8:

- Kompania Droid pret që në vitin 2015 fitimi për aksion të jetë 4,10€. Kjo pritje bazohet në analizën e fitimit të realizuar në të kaluarën dhe kushtet e pritshme në ekonomi dhe industri. Raporti P/E për firmat në industrinë e saj është 4.
- Përcaktoni vlerën e aksioneve të firmës?

## Detyra 9:

- Korporata “FOX” posedon 158.000 aksione. Vlera e teresishme e tregut te kapitalit aksionar eshte 2.8 milion euro. Te ardhurat neto te saj jane 242.000 €.
- Sa eshte raporti P/E?

# Detyra 10:

- Korporata Apple ka zhvilluar nje sistem operativ per kompjuter dhe dëshiron të përcaktoj kthimin e kërkuar të pasurisë  $X$  e cila ka betën me 1.15. Norma e kthimit pa rrezik është 7 %, kthimi i portfolios së tregut të pasurisë është 12 %.
- Atëherë sa është rendimenti i kthimit të kërkuar sipas ekuacionit CAPM?

# Detyra 11:

- Korporata A ka shitur obligacione te vleres nominale 75.000 euro me norme te kamates nominale 8%, maturim 5 vite, e te cilat paguajne kamate 2 here ne vit, me 30 qershor dhe me 31 dhjetor. Ne daten e shitjes se ketyre obligacioneve, norma e kthimit te kerkuar eshte 10%.
- Percaktoni vleren e ketyre obligacioneve.

## Detyra 12:

- Korporata A ka shitur obligacione te vleres nominale 30.000 euro me norme te kamates nominale 14%, maturim 6 vite, e te cilat paguajne kamate 2 here ne vit, me 30 qershor dhe me 31 dhjetor. Ne daten e shitjes se ketyre obligacioneve, norma e kthimit te kerkuar eshte 12%. Percaktoni vleren e ketyre obligacioneve.

# Detyra 13:

- Korporata B ka emetuar obligacione te vleres nominale 1000 euro, maturim 10 vite, norme te kuponit 8%. Meqenese obligacionet me rrezik te ngjajshem posedojne kthim te kerkuar me te madhe se 8%. Firma duhet te shet keto obligacione per 910 euro, perkatsisht me vlere me te vogel se ajo nominale, per ta kompenzuar kete rrezik. Kostot e emetimit dhe te shitjes jane 1.2% ndaj vleres nominale te ketyre obligacioneve. Llogaritni rendimentin e obligacioneve ne daten e maturimit?



# Detyra 14:

- Supozojmë se ju sot në revistat e Wall Street-it vëreni se çmimi për aksion i kompanisë është 12 euro dhe se dividendi në fund të vitit të kaluar është 1.18€ për aksion. Në qoftë se revista ndërkombëtare e bursave vlersojnë që dividendi për aksion rritet në çdo vit 5.65%.
- Llogaritni normën e kthimit të kërkuar (norma e kapitalizimit) përmes modelit të rritjes konstante të dividendit?

# Detyra 15:

- Kompania XYZ është një kompani shërbyese dhe prej vitit 2010 deri ne vitin 2015 ka paguar dividend në aksion si në vijim:

Viti	Dividendi për aksion
<b>2015</b>	2.05
2014	1.83
2013	1.71
2012	1.43
2011	1.28
<b>2010</b>	1.13

- Kompania XYZ deshiron te percaktojne koston e kapitalit ,ku vlera e tregut te aksioneve te saj eshte 35 €/aks. Firma pret te paguaje dividend ne fund te vitit 2016 prej 2.31€/aks.
- Llogaritni normen e kthimit te kerkuar (norma e kapitalizimit) përmes modelit të rritjes konstante te dividendit

# Detyra 16:

- Llogaritni shkallen interne te kthimit dhe trego cili nga projektet duhet te zgjidhet.
- Kompania X ka ne konsiderat te investoj ne nje projekt dhe ne kete drejtim ajo ka ne dispozicion dy projekte me dalje dhe marrje te keshit. Projekti A ka kosto 600.000 euro, ndersa projekti B 1.800.000 dhe se shkalla e kthimit te kerkuar per te dyja projektet eshte 15%. Te gjitha te dhenat per dy projektet lidhur me daljet dhe marrjet e keshit jane si ne vijim:

Viti	Projekti A	Projekti B
0	(600.000)	(1.800.000)
1	270.000	1.000.000
2	350.000	700.000
3	300.000	900.000



# Income statement example

**TEDDY FAB INC.**  
**STATEMENT OF INCOME**  
**Year Ended December 31, 2100**

Revenues	\$ 1,000,000
Cost of goods sold	200,000
<u>Gross profit</u>	<u>800,000</u>
<b>Operating expenses</b>	
Selling, general, and administrative expense	357,700
Interest expense	20,000
Depreciation and amortization expense	5,200
<u>Operating income</u>	<u>417,100</u>
Interest income	20,000
<b>Net earnings before taxes</b>	<u>437,100</u>
Income tax expense	<u>240,000</u>
<b>Net income</b>	<u><u>\$ 197,100</u></u>

# Raporti i likuiditetit

- Raporti korent

- $$\text{Raporti korent} = \frac{\text{Mjetet Rrjedhese}}{\text{Detyrimet afatshkurtera}}$$

- Raporti i shpejte (testi acid)

- $$\text{Raporti i shpejte} = \frac{\text{Mjetet rrejedhese} - \text{Stoqet}}{\text{Detyrimet afatshkurtera}}$$

- Raporti i parase se gatshme (keshit)

- $$\text{Raporti i parase se gatshme} = \frac{\text{P.G.} + \text{Ekuivalentet e P.G.}}{\text{Detyrimet afatshkurtera}}$$

- Raporti i kapitalit neto xhirues

- $$\text{Raporti i kapitalit n. xh.} = \frac{\text{Neto Kapitali Xhirues}}{\text{Mjetet totale}}$$

# Raportet e menaxhimit te mjeteve

- Raporti i qarkullimit te inventarit
- *Raporti i qarkullimit te stoqeve* =  $\frac{\text{Shitja}}{\text{Stoqet (Inventari)}}$
- Shitja ditore e inventarit
- *Shitja ditore e stoqeve* =  $\frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit te stoqeve}}$
- Raporti i qarkullimit te LL/A
- *Raporti i qarkullimit te LL/A* =  $\frac{\text{Shitja}}{\text{LL/A}}$
- Qarkullimi ditore i LL/A
- *Qarkullimi ditore i LL/A* =  $\frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit te LL/A}}$

# Raportet e menaxhimit te mjeteve

- Raporti i qarkullimit te mjeteve korente (xhiruese)
- *Raporti i qarkullimit te mj. xhiruese* =  $\frac{\textit{Shitja}}{\textit{Neto mj. xhiruese}}$
- Raporti i qarkullimit te mjeteve fikse
- *Raporti i qarkullimit te mj. fikse* =  $\frac{\textit{Shitja}}{\textit{Neto mj. fikse}}$
- Raporti i qarkullimit te mjeteve totale
- *Raporti i qarkullimit te mj. fikse* =  $\frac{\textit{Shitja}}{\textit{Mjetet totale}}$



# Raportet e borxhit ose solvences

- Raporti i borxhit total
- $Raporti\ i\ borxhit\ total = \frac{Asetet\ totale - Ekuiteti}{Asetet\ totale}$
- Raporti borxh/kapital
- $Raporti\ borxh/kapital = \frac{Borxhi\ total}{Ekuiteti}$
- Raporti i mbulimit te kamates
- $Raporti\ i\ mbulimit\ te\ kamates = \frac{FPKT}{Kamata}$
- Raporti i mbulimit me para te gatshme
- $Raporti\ i\ mbulimit\ me\ P.G. = \frac{FPKT + Zhvleresimi}{Kamata}$

# Raportet e profitabilitetit

- Raporti i margjines operative
- $Margjina\ operative = \frac{Fitimi\ operative(FPKT)}{Shitjet}$
- Raporti i margjines se profitit
- $Margjina\ e\ profitit = \frac{Te\ ardhurat\ neto}{Shitjet}$
- Kthimi ne mjete (ROA)
- $ROA = \frac{Te\ ardhurat\ neto}{Mjetet\ totale}$
- Kthimi ne ekuitet (ROE)
- $ROE = \frac{Te\ ardhurat\ neto}{Ekuiteti}$

# Raportet e profitabilitetit

- Fitimi per aksion (EPS)

- $$\text{Fitimi per aksion} = \frac{\text{Fitimi neto}}{\text{Nr.i aksioneve ne zotrim}}$$

- Vlera kontabel per aksion

- $$\text{Vlera kontabel per aksion} = \frac{\text{Ekuiteti}}{\text{Numri i aksioneve te shitura}}$$

- Raporti Cmim/Fitim

- $$\text{Raporti Cmim/Fitim} = \frac{\text{Cmimi per aksion}}{\text{Fitimi per aksion}}$$

# Modeli DU PONT

- Norma e kthimit prej kapitalit aksionar (ROE), duke zbatuar sistemin Du Pont, llogaritet me formulën e vijim:
- Norma e kthimit prej kapitalit aksionar
- $$ROE = \left(\frac{\text{Fitimi neto}}{\text{Shitjet}}\right) \left(\frac{\text{Shitjet}}{\text{Totali i pasurisë}}\right) \left(\frac{\text{Totali i pasurisë}}{\text{Ekuiteti}}\right)$$

## Detyra 18:

- Supozojme se kompania X ka 455,000 € shitje në vitin e parë dhe 620,000 € shitje në vitin e dytë. Për vitin e parë, shpenzimet operative të kompanisë ishin 182,000€, ndërsa në vitin dy, shpenzimet operative ishin 195,000 €.
- Llogariteni DOL dhe tregoni efektin e tij?

## Detyra 19:

- Supozojmë se korporata M në strukturën e financimit të saj ka 35% kapital borxh, 45% aksione të zakonshme dhe 20% aksione preferenciale. Kosto e kapitalit borxh është 8.40%, e aksioneve të zakonshme është 11% dhe aksioneve preferenciale 11.70%.
- Llogaritni koston mesatare të ponderuar?

## Detyra 20:

- Supozojmë se korporata A në strukturën e financimit të saj ka 15% kapital borxh, 60% aksione të zakonshme dhe 25% aksione preferenciale. Kosto e kapitalit borxh është 9.75%, e aksioneve të zakonshme është 12.70% dhe aksioneve preferenciale 9 %.
- Llogaritni koston mesatare të ponderuar?

Pyetje



Suksese!